



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL Anr.1097/2017

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Hasan Shala kryesues, Fejzullah Rexhepi dhe Adnan Konushevcu anëtarë, si dhe me pjesmarrjen e Zyrtares Ligjore Anita Peci, duke vendosur përkitazi me ankesën e Rrjetit Ballkanik për Gazetari Hulumtuese (BIRN) dhe Internews Kosova (IKS), me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) dega në Prishtinë, për shkak të thyerjes së Heshtjes Zgjedhore për raundin e dytë të zgjedhjeve për Kryetar të Komunave, në seancën e panelit të mbajtur me datë 21.11.2017, mori këtë:

### V E N D I M

**Pranohet** si e bazuar ankesa e Rrjetit Ballkanik për Gazetari Hulumtuese BIRN dhe Internews Kosova (IKS), me seli në Prishtinë, subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), dega në Prishtinë, i shqiptohet dënimi me gjobë në shumë prej 2,500.00 (dymijë e pesëqind) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e pranimit të këtij vendimi **nën kërcënim të përmbarimit**.

### A r s y e t i m

Me datën 19.11.2017, PZAP-i ka pranuar një ankesë nga Rrjeti Ballkanik për Gazetari Hulumtuese (BIRN) dhe Internews Kosova (IKS), me seli në Prishtinë, me të cilën pretendon se kandidati për anëtar të Kuvendit Komunal në Prishtinë, Agron Avdyli nga radhët e subjektit politik LDK, ka thyer heshtjen zgjedhore, pasi që me datë 19.11.2017 në orën 10:38 në rrjetin e tij social facebook ka shpërndar status me mbishkrimin “Voto 40, Arban Abrashi”. Sipas parashtruesit të ankesës ky veprim bie ndesh me nenin 36 të LZP-së.

Parashtruesi i ankesës si provë ka bashkangjitur fotografi lidhur me rastin në fjalë.

Në përgjigje në ankesë të datës 20.11.2017, subjekti politik LDK ka theksuar se, ankesën e parashtruar nga BIRN dhe IKS e konsideron të pabazuar, pasi që personi për të cilin bëhet fjalë në ankesë është një qytetar i zakonshëm meqë nuk ka ndonjë status që njihet sipas dispozitave ligjore të “ish kandidatit” për Kuvend Komunal. Po ashtu në përgjigje kanë theksuar se ai ka qenë kandidat për Kuvendin Komunal, rezultati përfundimtar i të cilave është shpallur, prandaj postimi i tij nuk mund të konsiderohet si postim i bërë nga një kandidatë i LDK-së.

Paneli, pasi që shqyrtoj ankesën dhe provat që gjenden në shkresat e lëndës në kuptim të nenit 117 të LZP-së gjeti se:

### **Ankesa është e bazuar**

Nga shkresat e lëndës shihet se Agron Avdyli, nga radhët e subjektit politik LDK, dega në Prishtinë, gjatë heshtjes zgjedhore në rrjetin e tij social facebook ka bërë thirrje për ta votuar kandidatin e LDK-së për kryetar të Kuvendit Komunal në Prishtinë, ku me këtë veprim ka shkelur Kodin e Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit dhe Kandidatet e tyre duke bërë thyerjen e heshtjes zgjedhore.

Sa i përket pretendimeve të subjektit politik LDK, për kandidatin në fjalë se ai më nuk mund të konsideohet kandidat i LDK-së, dhe se tani ai është një qytetar i zakonshëm pasi që nuk ka ndonjë status që njihet sipas dispozitave ligjore të “ish kandidatit”, Paneli i vlerësoi se nuk qëndrojnë sepse dispozita ligjore e nenit 32.5 *përcakton subjektet politike mbahen përgjegjëse për shkeljet e këtij Kodi të kryera nga anëtarët, mbështetësit dhe kandidatët e tyre*. Me këtë rast Paneli konstaton se është Agron Avdyli është mbështetës i subjektit politik LDK, andaj në këtë bazë rrjedh edhe përgjegjësia e subjektit politik të LDK-së.

Paneli me rastin e shqiptimit të gjobës si në diapozitiv të këtij vendimi, mori parasysh të gjitha rrethanat për rastin konkret duke pasur parasysh faktin se subjekti politik LDK ka marrë pjesë edhe në zgjedhjet e kaluara dhe se të njëjtit janë të njoftuar me rregullat zgjedhore. Po ashtu si rrethanë, Paneli e mori edhe faktin që këtij subjekti, ia dha mundësinë për tu përgjigjur ashtu që në përgjigjen e pranuar nga ana e tyre kanë mohuar shkeljen e supozuar, si dhe nuk kanë ofruar prova se kanë vepruar sipas nenit 32.6. Pretendimet e LDK-së në përgjigje në ankesë nga ana e Panelit janë vlerësuar si pa ndikim në marrjen e vendimit më të favorshëm për subjektin në fjalë.

Andaj, PZAP-i duke marr parasysh këtë si dhe në mbështetje të dispozitave ligjore të LZP-së konstaton se subjekti politik LDK është përgjegjëse për veprimet e saja pasi që ka shkelur nenin 36 paragrafi 1 pika b) e LZP-së.

Paneli në kuptim të nenit 120.1 pika c) dhe nenit 118.1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi

### **Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës**

ZL.Anr.1097/2017 me datë 21.11.2017



**Kryesues i Panelit**  
**Hasan Shala**

**Këshillë juridike:** Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118.4 të LZP-së.